



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 32-të (e Jashtëzakonshme) të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 09.06. 2020, në sallën e Kuvendit me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Mehmetali Krasniqi, anëtar
3. Nehat Tërpeza, anëtar
4. Hyra Bytyçi, anëtare
5. Anila Reçica, anëtare
6. Ramadush Tasholli, anëtar
7. Naim Jahiri, anëtar
8. Naim Stullca, anëtar
9. Majlinda Sylejmani, anëtare
10. Fatime Krasniqi, anëtare
11. Arif Miftari, anëtar
12. Lulzim Rrustemi, anëtar
13. Ramiz Qeriqi, anëtar
14. Argjent Tasholli, anëtar
15. Nazmi Krasniqi, anëtar
16. Lumturije Bytyqi-Hasani
17. Egzona Bytyqi, anëtare
18. Shkelzen Bislimi, anëtar
19. Albulena Kelmendi, anëtare
20. Alban Salihu, anëtar
21. Afrim Miftari, anëtar
22. Hajdin Bytyqi, anëtar
23. Safete Amerllahu, anëtare
24. Bashkim Budakova, anëtar
25. Ukë Kryeziu, anëtar
26. Ganimete Qeriqi, anëtare
27. Manush Shamolli, anëtar
28. Egzona Fazliu, anëtare
29. Arben Salihu, anëtar
30. Fehmi Rexhepi, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, kryetar i Komunës
2. Avni Olluri, drejtor i DA
3. Latif Ramadani, drejtor i DBF-së

4. Bekim Shabani, drejtor i DEZH-së
5. Emina Rexhiq, drejtoreshë e DPU
6. Besart Troshupa, zyra e informimit
7. Bestar Ibrahim, zyrtar i teknologjisë
8. Përfaqësues të mediave dhe numër i konsiderueshëm i qytetarëve

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, pas konstatimit se në mbledhje prezentojnë shumica e anëtarëve të Kuvendit, hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit.

Pastaj tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë dhe në vazhdim lexoi rendin e ditës të propozuar.

REND DITE

1. Propozim vendim mbi rishikimin e buxhetit për vitin 2020

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, hudhi në votim rendin e ditës

I

Propozim vendim mbi rishikimin e buxhetit për vitin 2020

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën, Latif Ramadanit, drejtor i DBF-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Nehat Tërpeza, një dokument i pasqyruar mirë ku është ngritur infrastruktura në vendet rurale po ashtu edhe atë urbane. E ku vlenë të theksohet ndërtimi i lapidarit të tre dëshmorëve Hajredin Bajrami, Xhavit Kozhani dhe humanistit Ruzhdi Shabani. Ne si grup parlamentar i LDK-së e përkrahim këtë propozim vendim.

Lulzim Rrustemi, mendoj që duhet me pas ristukturim të këtij buxheti. Unë propozoj që të përfshihet edhe rruga "Shefki Salihu" e cila ka gjatësi dikun 200 m. Po ashtu te ndërtimi i tre lapidarëve propozoj që të ndërtohet edhe lapidari i Bashkim Krasniqit nga Zllakuqani.

Lumturije Bytyqi-Hasani, po më vjen mirë që është leju të ketë rishikim të buxhetit por nuk po e shoh rrugën dhe trotuarin te QKMF në Lipjan, unë kërkoj që të tërhiqen 10 mijë euro te lumi në Dobrajë dhe të riparohet trotuari në QKMF.

Argjent Tasholli, unë kam një pyetje te mjetet e mbetura te rruga "Gjakova" në Vrellë a është bërë vlerësimi i asaj rruge pasi që ajo rrugë është e pa përfunduar dhe duhet të vazhdohet deri te shkolla në fshat.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, ideja ka qenë që në rishikim të përfshihen projektet që janë më të mëdha dhe të cilat marrin kohë procedurat e tenderimit dhe koha e implementimit.

Rruga të cilën e përmendi Luli është e projektuar dhe kontraktuar për punën por telashe po na shkakton hekurudha.

Projektet për lapidarët është dy vjeçarë dhe shpallet përmes konkursit.

Gjatë takimit me kryetarët e komunave dhe Ministrin e shëndetësisë është kërku që të respektohen rregullat e institutit kombëtar, të mbahet distanca, të mos folet përdore dhe të mbahen dizenfektues, të respektohen të gjitha rregullat.

Ramiz Qeriqi, jam i nderum që i kam njoft të tre këta persona por jam edhe falenderues që po ndërtohen lapidarët e tyre por unë kam bërë kërkesë edhe më herët që të ndërtohet edhe lapidarët për Bashkim Krasniqin dhe ju më keni thënë se nuk do të ndërtojmë lapidarë. Kërkoj nga Kuvendi që të votojmë edhe për ndërtimin e lapidarit të Bashkim Krasniqit.

Ukë Kryeziu, edhe ne e përkrahim çdo riorganizim- rishikim të buxhetit pasi që kjo e rritë efikasitetin e punës. Kërkoj një sqarim nga ana e Kryetarit ose drejtorit se ku do të vendoset pllaka përkujtimore në Sllovi.

Imri Ahmeti, unë nuk kam thënë që nuk do të ndërtoj lapidarë por kam thënë që do të ndërtoj bile edhe atë do ta ndërtoj edhe obileskun e të gjithë dëshmorëve dhe martirëve në shesh. Po ashtu ne disa herë kemi rregulluar varrezat në Hallaq të Vogël, Ribarë të Vogël dhe Sllovi. Po ashtu jemi duke kontraktuar dikend për mirëmbajtjen e varrezave. Ne duhet me mbyllë këtë temën e lapidarëve duhet së bashku me shoqatat e dalura nga lufta me e gjetë një zgjidhje për këtë çështje.

Lulzim Rrustemi, do të ishte mirë që ne të gjithë së bashku me drejtoratin për kulturë, shoqatat e dalura nga lufta të bëjmë një listë duke mos i hy në hak askujt dhe të përfshihet një pllakë.

Ne kërkojmë që të përfshihet edhe lapidari i Bashkim Krasniqit nga Zllakuqani.

Po ashtu edhe propozimi i Lumes që të hiqen 10 apo 15 mijë euro te lumi i Dobrajës dhe të rregullohet trotuari në QKMF në Lipjan.

Ramiz Qeriqi, unë e kam vendimin e komunës ne të cilin thuhet se nuk do të ndërtohet lapidari, unë këtu nuk jam për t'ia bërë qefin askujt por do t'i mbroj vlerat e luftëtarëve. Kam një propozim që të riparohen odat e Ruzhdi Shabanit dhe e Hajredin Bajramit. Unë kërkoj që të futet edhe lapidari për Bashkim Krasniqin përndryshe nuk do të mund ta votoj.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, lumi në Dobrajë në pjesën në fund të fshatit është në gjendje jo të mirë dhe nuk po e shoh të arsyeshme të hiqen mjetet prej atje e të shkojnë në QKMF pasi te QKMF është punë e vogël dhe mund të kryhet me ridestininim por nëse e shihni të arsyeshme e bëjmë. Pllaka përkujtimore në Sllovi do të vendoset te Lugu i Demit.

Naim Stullca, unë mendoj që duhet të përfshihet edhe lapidari i Lulzim Llugiqit. Po ashtu nuk pajtohem që të hiqen mjetet e lumit në Dobrajë pasi që aty është shumë e nevojshme të punohet.

Lulzim Rrustemi, është mirë këtë herë të futet edhe dëshmori Bashkim Krasniqi pastaj të fillojmë me dëshmorë tjerë.

Ganimete Qeriqi, duhet të përfshihet edhe Vezir Kolshi nga fshati Baicë i cili ka dhënë sakrificë të madhe.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi tha që të shkojmë me votimin për tre lapidarët siç ka qenë në propozim, ndërsa 15 mijë euro të hiqen te shpronsimi ku janë parapar 100 mij euro, aty mbeten vetem 85 mij euro, ndërsa 15 mij euro kalojnë në ndërtimin e trotuarit në QKMF në Lipjan

Pastaj Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 30 votat për, aprovoi këtë:

VENDIM MBI RISHIKIMIN E BUXHETIT PËR VITIN 2020

Neni 1

Me këtë Propozim Vendim rishikohet buxheti në kategorine Investime Kapitale (fondi burimor 10) në shumë prej **319,769.59€**

Neni 2

Investime Kapitale Fondi burimor (10):

Mjetet e mbetura nga projektet :

Shërbime Publike.MCE(180),Nënprogrami i Infrastrukturës Publike (18163)

Nr.	Kodet	Emërtimet e projekteve	Buxheti fillestar	Rishikimi (mbetja)
-----	-------	------------------------	-------------------	--------------------

1	49155	Asfaltimi i rrugicave në fshatin Poturovc	52,293.00	14,905.36
2	49334	Asfaltimi i rrugës Gllanicë- Torine	68,000.00	30,614.30
3	49335	Asfaltimi i rrugëve në Banullë (Lagjeja Ibrahim, Lagjeja Hajrullahu, Livadhet e Banulles, etj)	58,000.00	11,958.72
4	49339	Asfaltimi i rrugëve në Fshatin Lluga	64,000.00	14,842.60
5	49341	Asfaltimi i rrugëve Vrellë e Gadimes(Rruga Gjakova)	28,000.00	6,571.00
6	49144	Ndërtimi i rrugicave me kubeza në Janjevë(Bajram Gajtani, Dardania, Pjeter Mazreku, Dubrovniku, Shkelzen Haradinaj dhe rrugica tjera)	62,000.00	17,021.14
7	49141	Asfaltimi i rrugëve Ribar i Madh (Vehbi Kozhani, Ajet Kozhani, Rrahim Hoti, Beqir Durici, Agim Bllaca, Hamdi Hoti etj)	68,000.00	19,480.50
8	49345	Asfaltimi i rrugëve në Topliqan (Islam Elshani, Kamer Sylejmani dhe rruga Mbretëria Dardane etj)	68,000.00	4,064.59
9	49350	Asfaltimi i rrugicave në Glogovc	66,000.00	14,575.27
10	49355	Ndërtimi i rrugicave në fshatin Dobraje e Madhe	58,000.00	10,706.06
11	49364	Asfaltimi i rrugicave në Vrellë të Magures	69,000.00	24,493.04
12	49369	Asfaltimi i rrugicave në Qallopek	39,000.00	14,331.12
13	49371	Asfaltimi i rrugicave në Bujan	69,000.00	21,583.00
14	49157	Ndërtimi i shtratit të lumit në Konjuh Faza II	25,000.00	4,122.89
14	47422	Mirëmbajtja Investive e Ndriqimit Publik në Qytet dhe Fshatra (kodi47422)	70,000.00	30,000.00
15	49365	Asfaltimi i rrugicave në Bujari	56,000.00	28,000.00
		Totali	920,293.00	267,269.59

Arsim dhe Shkencë (920),Nënprogrami i Arsimit Parafillor (92250) nga projekti

Nr.	Kodet	Emërtimet e projekteve	Buxheti fillestar	Rishikimi (mbetja)
1	49151	Riparimi i kulmit në Qerdhe	27,000.00	9,000.00
2		Totali	27,000.00	9,000.00

Arsim dhe Shkencë (920),Nënprogrami i Arsimit Fillor (93060) nga projektet

Nr.	Kodet	Emërtimet e projekteve	Buxheti fillestar	Ndryshim i 5%	Buxheti në SMFK	Rishikimi (mbetja)
1	49380	Zgjerimi dhe Instalimi i Kamerave IEA	56,000.00	12,500.00	43,500.00	43,500.00
2		Totali	56,000.00	12,500.00	43,500.00	43,500.00

Mjetet e mbetura nga projektet nga granti qeveritar (10) barten(rishikohen) në keto projekte:

Shërbime Publike.MCE(180),Nënprogrami i Infrastrukturës Publike (18163)

Nr.	Kodet	Emërtimet e projekteve	Rishikimi
	I ri	Rikonstruimi i ndriqimit publik në qytetin e Lipjanit	85,000.00
	47776	Mjetet e dedikuara për shpronësim	85,000.00
	I ri	Vazhdimi i ndërtimit të shtratit të lumit në Dobrajë të Madhe	65,000.00
		Totali	235,000.00

Shërbime kulturore(850), Nënprogrami Shërbime Kulturore (85003)

Nr.	Kodet	Emërtimet e projekteve	Rishikimi
	I ri	Ndërtimi i fushës ndihmëse në Dobrajë të Madhe	28,000.00
	I ri	Ndërtimi i tre lapidarëve (Xhavit Kozhani, Haradin Bajrami, Ruzhdi Shabani,dhe ndërtimi i pllakës përkujtimore në Sllovi) project dyvjeçar	41,769.59

		Totali	69,769.59
--	--	---------------	------------------

Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale (730), nënë programi shërbimet e shëndetësisë primare (73200)

Nr.	Kodet	Emërtimet e projekteve	Rishikimi
	I ri	Rregullimi i infrastructures në oborrin e QKMF-së	15,000.00
		Totali	15,000.00

Neni 3.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa

Neni 4.

Ky Vendim hyn në fuqi 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës..

Neni 5.

Me këtë Vendim të njoftohet Drejtorati për Buxhet dhe Financa, MF-Prishtinë dhe MAPL ndërsa një kopje ruhet në materialin e Kuvendit.

Shtesë: Vendimi.

Pasi çështje të tjera nuk pati mblledhja përfundoi në ora 11,¹⁵

Ekstraktin e hartoi
Behar Aliu

Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi